



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:283598

Datë: 08.10.2024

Numri i dokumentit: 06268026

K.DH.SH.II.nr.728/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Ramush Bardiqi, anëtare të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit N.T.Sh. “Neziri” me seli në Gjakovë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCRL Partners” me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti Fiskal, KF.nr.41/22 të datës 20.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 08.10.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet ankesa e të paditurës, Administrata Tatimore e Kosovës, e datës 08.03.2024, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti Fiskal, KF.nr.41/22 të datës 20.02.2024, **Vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Dhoma e Shkallës së Parë- Departamenti Fiskal, me aktgjykimin e ankimuar, në pikën I të dispozitivit ka vendosur I. Aprovohet kërkesëpadia e paditësit NTSh. “Neziri” me seli në Gjakovë,. Në pikën II. Anulohet pjesërisht vendimi i Administratës Tatimore të Kosovës me seli në Prishtinë nr.328/2019 i datës 18.09.2019, dhe atë vetëm në pjesën që i referohet TVSH-së për periudhën 2010-2015 në shumën prej 28,463.17€ të tatimit në fitim për periudhën 2010-2014 në shumën prej 25,359.38€. Në pikën III. Obligohet e paditura Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësin NTSh. “Neziri” me seli në Gjakovë, ta liroj nga obligimet tatimore të përcaktuara më tepër dhe atë për TVSH për periudhën 2010-2015 në shumën prej 28,463.17€ dhe të tatimit në fitim për periudhën 2010-2014 në shumën prej 25,359.38€ e të gjitha këto në shumën prej

53,822.55€ në afat prej 15 ditësh nga nxjerrja e këtij aktgjykimi. Në pikën IV. mbetet në fuqi vendimi i të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë nr.328/2019 i datës 18.09.2019 në pjesën jo kontestuese dhe atë për TVSH për periudhën 2010-2015 në shumën prej 3,309.36€ dhe për tatimin në fitim për periudhën 2010-2014 në shumën prej 2,068.35€ si dhe ndëshkimi prej 25% në këtë shumë sipas raportit të kontrollit të datës 21.06.2016 të Administratës Tatimore të Kosovës dhe njoftim vlerësimet nga e paditura. Nën pikën V. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij vendimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar e paditura ATK, me të cilën e kundërshton ligjshmërinë e aktgjykitimit për shkak të; shkeljes së dispozitave të procedurës administrative, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, propozon që të aprovohet ankesa e Administratës Tatimore të Kosovës, si e bazuar, të anulohet në tërësi aktgjykimi i Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal KF.nr.41/22 lidhur me paditësin NTSh “Neziri”, dhe të mbetet në fuqi si i plotë vendimi i Departamentit të Ankesave nr.328/2019 datë 18.09.2019.

Paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur përgjigje në ankesë, duke konsideruar se ankesa është e pa bazuar, pasi Që aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë është i bazuar në gjendjen reale faktike dhe bazuar në ekspertizat financiare dhe se Gjykata ka aplikuar drejtë dispozitat materiale, andaj propozojmë që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës ushtruar kundër aktgjykitimit të Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal KF.nr.41/22 datë 20.02.2024.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e Aktgjykitimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.h, të Ligjit, nr.04/L-102, për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-222, dhe nenit 194 i LPK-së, (ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së), në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e pa bazuara.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, e paditura me Vendimin, nr.328/2019 i datës 18.09.2019, nën pikën I. të dispozitivit, refuzohet si e pa bazuar ankesa nr.328/2019 për subjektin e NTSh. “Neziri” me NUI 810225781 me adresë “Nëna Terezë-Gjakovë, në ri procedurë sipas Aktgjykitimit të Gjykatës Themelore A.nr.1603/16 në mbështetje të nenit 77 paragrafi 7 të Ligjit nr.03/L-222 “Për Administratën Tatimore dhe Procedurat” në lidhje me paragrafin 2 të nenit 89 të Ligjit nr.03/L-222”Për Administratën Tatimore dhe Procedurat”. Njoftim Rivlerësimet e Tatimit Shtesë të caktuara me kontroll, vërtetohen si të bazuara. Nën pikën II. Procedura e ankesës nuk ndërpre në sanksionet për mos përmbushje dhe interesin për ndonjë lloj tatimi, sipas Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

I pakënaqur me vendimin e ATK-së, paditësi, ushtron padi në gjykatën, në procedurë të konfliktit administrativ. Dhoma e Shkallës së Parë pas administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, dhe vërtetimit të gjendjes faktike gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar me të cilin e aprovon të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, sipas konkludimeve ndër të tjera në arsyetim se: Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, gjykata ka konstatuar se e paditura Administrata Tatimore e Kosovës – Departamenti i Ankesave në shkallë të dytë e ka refuzuar ankesën e subjektit tatimor këtu paditësit, me arsyetim se vlerësimi zyrtar nga ana e ATK-së është bërë komfor nenit 14, 15 dhe 19 të Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Tutje ka theksuar se Divizioni i Ankesave pas analizimit të shkresave në lëndë, përkatësisht aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, si dhe provave tjera materiale të bashkangjitura ankesës nga tatimpaguesi dhe analizimit të pretendimeve ankimore, si dhe informatave shtesë të verifikuara nga regjioni vendos se vlerësimi i kontrollit paraqet bazë ligjore për të lënë në fuqi vlerësimin e kontrollit sa i përket dyfishimit të përlllogaritjes së të hyrave, inkasimeve dhe pagesave në xhirollogarinë bankare të tatimpaguesit, si dhe nuk është mbështetur konstatimi i diferencës së tatimit shtesë në asnjë provë konkrete se kemi të bëjmë me nën deklaram të qarkullimit, e që do të gjente mbështetje edhe në dispozitat ligjore. Për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimin e vendimit kontestues dhe pretendimet e paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata sipas propozimit të autorizuarit të palës paditëse përmes aktvendimit ka caktuar ekspertizë financiare në këtë kontest tregtar administrativ me ekspertin financiar Riza Blakaj. Gjykata, sipas propozimit të autorizuarit të palës paditëse përmes aktvendimit KF.nr.41/22 të datës 02.11.2022 ka caktuar grupin prej 3 ekspertëve financiar dhe atë: ekspertët financiar E.P., R.S. dhe A.K. në këtë kontest tregtar administrativ, me detyrat përkatëse si në dispozitiv të këtij aktvendimi, të cilët kanë nxjerrë ekspertizën e datës 01.12.2023, e cila është plotësuar me datën 22.01.2024, në të cilat është dhënë mendimi dhe konstatimi se: “Grupi i ekspertëve pas vërtetimit të saktë të gjendjes dhe konstatimit profesional të bërë për periudhën 2010-2015, rekomandon që për periudhat e përshkruara më sipër dhe që kanë të bëjnë me TVSH (Tatimin e Vlerës së Shtuar) dhe PD (Tatimin në të Ardhurat Personale)të bëhen korrigjimet në atë mënyrë që vlerat e konstatuara me Raport të Kontrollit të zbriten për vlerat sipas tabelës për qarkullimin shtesë të ngarkuar me Raportin e Kontrollit nga Administrata Tatimore e Kosovës të datës 21.06.2016, dhe atë (për TVSH 2010-2015 në shumën prej 28,463.17 € dhe Tatimit në Fitim 2010-2014 në shumën prej 25,359.38 €). Eksperti financiar E.P., në emër të grupit të ekspertëve në seancë ka theksuar se: “Mbesim në tërësi pranë ekspertizës dhe plotësim ekspertizës dhe jemi të gatshëm të përgjigjemi lidhur me pyetjet që palët mund të kenë. Për detyrë kemi pasur që ti verifikojmë të gjitha pagesat e realizuara përmes sistemit bankar dhe atë pagesat nga subjektet e ndryshme, deponimet e pazarit ditor dhe pagesat përmes POS, si dhe lëvizjet e transferit brenda llogarive bankare. Janë verifikuar te gjitha transaksionet nga llogarit bankare dhe të njëjtat janë paraqit në ekspertizë financiare nga fq.6 –fq.10, po ashtu edhe në plotësim ekspertizë financiare. I kemi verifikuar llogarit si më lartë,

përfshirë edhe një llogari tjetër në bankën TEB për vitin 2010, ngase në atë vit ka pasur qarkullim në atë llogari bankare tjetër nga ato të lartcekurat”. Gjykata ka gjetur se grupi i eksperteve financiar me rastin e dhënies së konstatimeve sa i përket gjendjes faktike sikurse në super ekspertizën financiare të datës 01.12.2023 dhe plotësimin të saj të datës 22.01.2024 ka shqyrtuar të dokumentacionit përcjellës këtu të paditësit, dokumentacion ky i cili është trajtuar edhe nga e paditura në procedurën administrative dhe ka gjetur se për vitin 2010 qarkullimi total është në shumën prej 261,450.80€ dhe jo sa është deklaruar nga paditësi në shumë prej 260,886.80€ me një diferencë prej 564.00€ e nga e cila shumë rezulton edhe obligimi për TVSH për vitin 2010 në shumë prej 77.79€ dhe për tatimin në fitim në shumë prej 48.62€. Gjykata ka gjetur se për vitin 2011 sipas super ekspertizës financiare qarkullimi është në shumë prej 241,848.39€ dhe jo sikur është deklaruar nga paditësi në shumë prej 218,469.56€, pra me një diferencë prej 23,428.83€ e nga i cili qarkullim rrjedh edhe obligimi shtesë për TVSH në shumë prej 3,231.56€ ndërsa tatimi në fitim në shumë prej 2,029.73€ shuma këto në të cilat duhet të kalkulohet edhe ndëshkimi prej 25%, derisa për vitet 2012 deri 2015 nuk është gjetur gjendje tjetër e konstatuar nga ajo e deklaruar nga këtu paditësi, periudhe kjo e cila nuk konsiston me obligime për TVSH dhe tatim në fitim. Gjykata përfundimisht, bazuar në super ekspertizë dhe plotësim të saj ka ardhur deri tek konstatimi se qarkullimi shtesë më tepër i ngarkuar nga e paditura me raport kontrolli ka ardhur si rezultat i lëvizjeve të mjeteve në llogaritë bankare respektivisht lëvizjet nga një bankë në tjetrën, lëvizje këto që sipas grupit të eksperteve financiar nuk është dashur të ndikojnë në rritjen e qarkullimit shtesë për periudhat kontestuese përveç atyre të gjeturave për të cilat është konstatuar qarkullimi me efekt tatimor shtesë. Mbi bazën e kësaj gjendje faktike, gjykata vlerëson se pretendimi i paditësit është plotësisht i bazuar dhe i drejtë dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore për nga obligimet tatimore të përcaktuara më tepër, dhe atë për TVSH-ë për periudhën 2010-2015 në shumën prej 28,463.17 €, dhe të tatimit në fitim për periudhën 2010-2014 në shumën prej 25,359.38 €. Paditësi qysh në fazën e kontrollit por edhe gjatë fazës së ankimimit ka paraqitur librat kontabël dhe të dhënat e llogarive bankare dhe mbi këtë bazë edhe ka dëshmuar lëvizjen e mjeteve nga njëra llogari në llogarinë tjetër bankare, fakt ky i konstatuar me super ekspertizë financiare, mirëpo e paditura nuk i ka marrë për bazë këto dokumente dhe pa një konstatim të saktë të gjendjes faktike dhe elaborim të bazës ligjore ka ardhur deri tek vendimi kontestues.

Dhoma e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, i pranon në tërësi si të drejta dhe ligjore konkludimet juridike të Dhomës së Shkallës së Parë, sa i përket gjendjes faktike të çështjes, e gjithashtu aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ, të cilat shkelje Dhoma e Shkallës së Dytë i vlerëson sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 49 të LKA dhe 194 të LPK. Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, mbështetur edhe nga dispozitat e nenit 8 të Ligjit për -në drejtim të thënieve në padi, përgjigjes në padi, ekspertizës financiare dhe plotësimin të saj si dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesorë dhe ka vlerësuar drejtë, se kërkesë padia e paditësit është e bazuar,

duke e anuluar pjesërisht vendimi nr.328/2019 i datës 18.09.2019 i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë. Në pikën III. Obligohet e paditura Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësin ta liroj nga obligimet tatimore të përcaktuara më tepër dhe atë për TVSH për periudhën 2010-2015 në shumën prej 28,463.17€ dhe të tatimit në fitim për periudhën 2010-2014 në shumën prej 25,359.38€ e të gjitha këto në shumën prej 53,822.55€ në afat prej 15 ditësh nga nxjerrja e këtij aktgjykimi. Në pikën IV. mbetet në fuqi vendimi i të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë nr.328/2019 i datës 18.09.2019 në pjesën jo kontestuese dhe atë për TVSH për periudhën 2010-2015 në shumën prej 3,309.36€ dhe për tatimin në fitim për periudhën 2010-2014 në shumën prej 2,068.35€ si dhe ndëshkimi prej 25% në këtë shumë sipas raportit të kontrollit të datës 21.06.2016 të Administratës Tatimore të Kosovës dhe njoftim vlerësimet nga e paditura.

Sa i përket pretendimit të paditurës se gjykata me përpilimin e aktgjykimit ka bërë shkelje esenciale të dispozitave ligjore në përpilimin e dispozitave të tij. Gjykata në dispozitivin e këtij aktgjykimi nuk ka specifikuar shumat përkatëse të periudhave tatimore përkatësisht shumat specifike se cilat deklarata tatimore apo cilat vlerësime tatimore ndryshohen, andaj dispozitivi i aktgjykimit nuk është fare i qartë dhe nuk është i ndarë për periudha përkatëse tatimore duke krijuar paqartësi se cilat Njoftim Rivlerësime të ndryshohen, kolegji i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i vlerëson se nuk janë të qëndrueshme, sepse nuk janë të bazuara në prova dhe fakte të dëshmuara andaj kolegji gjen se aktgjykimi i ankimuar, nuk është i përfshirë me shkelje procedurale dhe ligjore siç pretendohet, sepse e njëjta ka shqyrtuar padinë, përgjigjen në padi pastaj ka caktuar seancë të shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme e që kuptohet se gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së. Andaj sipas vlerësimit të kolegjit, aktgjykimi i ankimuar i Dhomës së Shkallës së Parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, ngase nuk është shkelur ligji material në dëm të paditurës.

Po ashtu pretendimi se gjykata në përshkrimin e provave tek pjesa arsyetuese i përshkruan edhe gjetjet e llogarive bankare/transaksionet të cilat ekspertiza financiare nuk i ka trajtuar e në anën tjetër ka nxjerr aktgjykim i cili fare nuk ka mbështetje në këto prova të cilat fare nuk kanë qenë të refuzuara nga ana e Gjykatës, andaj konsiderojnë se gjykata ka bërë shkelje flagrante të dispozitave ligjore përkatësisht nenit 8 të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore. Prandaj, konsiderojnë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vlerësuar provat e administruara dhe po ashtu gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale në dëm të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, duke aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit. Kolegji i shqyrtoi me kujdes dhe të njëjtat i refuzon si të pa bazuara në prova dhe fakte të dëshmuara, duke konsideruar se Dhoma e Shkallës së Parë ka konsideruar se Paditësi qysh në fazën e kontrollit por edhe gjatë fazës së ankimimit ka paraqitur librat kontabël dhe të dhënat e llogarive bankare dhe mbi këtë bazë edhe ka dëshmuar lëvizjen e mjeteve nga njëra llogari në llogarinë tjetër bankare, fakt ky i konstatuar me super ekspertizë financiare, mirëpo e e paditura nuk i ka marrë

për bazë këto dokumente dhe pa një konstatim të saktë të gjendjes faktike dhe elaborim të bazës ligjore ka ardhur deri tek vendimi kontestues, andaj Dhoma e Shkallës së Parë në bazë të provave të administruara në seancën kryesore nga grupi i eksperteve financiar në super ekspertizën financiare të datës 01.12.2023 dhe në plotësimin e super ekspertizës financiare të datës 22.02.2024 si dhe shkresave të tjera ka nxjerrë prova të mjaftueshme dhe në mënyrë të plotë dhe të drejtë e ka vërtetuar gjendja faktike, me rastin e aprovimit të kërkesë padisë së paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, bazuar në faktet e paraqitura si në arsyetim të aktgjykimit të mbështetura në dispozitat ligjore tatimore.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës, sepse Dhoma e Shkallës së Parë nuk ka gjetur dëshmi që do të mund të vërtetonte një gjendje tjetër faktike nga gjendja faktike e konstatuar nga Dhoma e Shkallës së Parë, për arsye se e paditura nuk ka ofruar prova të bazuara që do të ndryshonin gjendjen faktike të vërtetuar. Andaj, sipas vlerësimit të kolegjit, aktgjykimi i ankimuar i Dhomës së Shkallës së Parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, ngase nuk është shkelur ligji material në dëm të paditurës.

Mbi këtë gjendje të fakteve kolegji vlerëson, se Dhoma e Shkallës së Parë, drejtë kanë vërtetuar gjendjen faktike të çështjes në shqyrtim dhe drejtë ka zbatuar dispozitat e Ligjit nr. 04/L-102, dhe të LKA-së, dhe nuk është cenuar e drejta dhe ligji në dëm të paditurës. Pasi që me thëniet në ankesë aktgjykimi nuk vihet në dyshim, i njëjti vërtetohet si drejtë i bazuar në prova dhe ligj.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.728/24, me datë 08.10.2024

Kryetar i kolegjit,
Faton Bajrami